

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për mospranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr. 04,  
paraqitur në KOZ në datën 03.03.2022”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.L.Braho.
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”
- **Të tjerë:** Znj.V.Ademi (Kryetare e B. Shkodër)

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve! Fillojmë seancën për vlerësimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 4, të paraqitur nga subjekti zgjedhor, koalicioni “Shtëpia e Lirisë” me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.116, datë 02.03.2022. Sipas shortit të hedhur dje, relatori i kësaj çështjeje do jem unë, Elvis Çefa. Janë prezentë anëtarët e KAS-it, është prezent subjekti ankimues i përfaqësuar nga avokat Altin Kaziaj, është prezente administrata e KQZ, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Besoj që tashmë jeni në dijeni të faktit që duhet të paraqitni nëse keni pretendime për ndonjë konflikt të mundshëm interesi ndaj anëtarëve të KAS-it. Nuk ka! Anëtarët e KAS-it, ndonjë deklaram për konflikt interesi? Nuk ka! Kështu që nuk ka pengesë për të vazhduar vlerësimin e kritereve paraprake. I jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm, shkurtimisht, për të parashtruar rrethanat e çështjes!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

**Z. Y. Merkaj:** Po! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa Ankimore nr.4, në datë 03.03.2022, me ankues, koalicionin “Shtëpia e Lirisë”, me objekt ankimi “Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve” nr.116, datë 02.03.2022, i cili ka shqyrtuar kërkesën e Bashkisë Shkodër, për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022. Kërkesa ankimore nga një shqyrtim paraprak është në përputhje me nenin 126, të Kodit Zgjedhor, pasi nga forma dhe përmbajtja i plotëson kriteret e kërkuara nga ky nen, pasi ka emrin e plotë të subjektit zgjedhor dhe adresën e tij, referimin e vendimit që ankimohet, bazën ligjore, përshkrimin e shkurtër së shkeljes së pretenduar, përshkrimin e fakteve e argumenteve, dispozitave tek të cilat mbështet ankimi, gjithashtu pretendimi i fakteve dhe provave për të cilat kërkohet të merren gjatë procesit të shqyrtimit dhe datën dhe firmën e ankimuesit. Gjithashtu është në përputhje me nenin 130, të Kodit Zgjedhor. Kompetencë e KQZ-së KAS-i është organi kompetent në të cilin shqyrtohen ankesat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, legjitimitimin e ankuesit në këtë proces, pasi ka interes të ligjshëm për procesin e votimit dhe është respektuar afati ligjor i ankimit, është bërë brenda afatit 24-orësh.

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Avokat ndonjë diçka tjetër për këtë fazë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Jo, për fazën e verifikimit paraprak, i nderuar zoti relator, jemi dakord me relacionin që bëri Sekretari i Përgjithshëm. Jemi drejtuar, siç tha dhe Sekretari në afatin e parashikuar brenda 24-orëve nga vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni dhe vendimin e ankimueshëm. Po ashtu në seancën, kur të kalohet në seancë shqyrtimi,

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

të themi, themeli, do vëmë në dispozicion të këtij komisioni dhe prova të tjera, mbi të cilat ne kërkojmë që kërkesa jonë ankimore të merret parasysh dhe të pranohet, duke shfuqizuar vendimin e Komisionerit. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Dakord, ju faleminderit! Kolegët? Po, zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Subjekti juaj nuk është nismëtar i kësaj kërkesë, apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Në ç'kuptim zoti Rumali?

**Z. I. Rusmali:** Nuk e keni vënë ju në lëvizje KQZ-në!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Subjekti ynë nuk e ka vënë në lëvizje KQZ-në, por duke qenë se kemi interes të ligjshëm, në këtë rast, për shkak të vetë mbrojtjes kushtetuese që i jepet të drejtës së votës të këtyre votuesve, 12 qendrave të votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i vendndodhjes, i nderuar zoti Rusmali, mendoj dhe besojmë që interesi i ligjshëm, interesi madhor i së drejtës së votës, justifikon vendimmarrjen tonë për ankimimin e këtij vendimi të Komisionerit. Po ashtu duke shkuar dhe në, të themi në atë që është praktika e vendimmarrjes së Komisionerit, duke qenë dakord vetë KZAZ-ja përkatëse me ndryshimin e vendndodhjes për shkak të kushteve të rënduara klimaterike dhe të afatit në të cilin ndodhemi, në sensin që jemi në muajin mars, ku në zonat e thella për të cilat kërkohet ndryshimi i vendndodhjes është...

**Z. I. Rusmali:** Mos u fut tek përmbajtja, të lutem! Vetëm kaq! Ju nuk e keni vënë në lëvizje! Do harxhojmë kohën tuaj dhe tonën kot. Koha është e rëndësishme, e

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

krahasojnë me floririn ndonjëherë. Mos harxhoni kohën, po diskutojmë vetëm probleme që kanë lidhje vetëm me legjitimitimin dhe me kompetencën. Në lëvizje nuk e keni vënë. Nuk keni kërkuar që të paraqiteni si palë e interesuar gjatë shqyrtimit nga Komisioneri, apo jo?

*Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":* Dua të vë këtë komision dhe juve si anëtar i tij, duke më bërë këtë pyetje.

*Z. I. Rusmali:* Kjo është e rëndësishme!

*Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":* Po të keni lexuar, i nderuar këtë...

*Z. I. Rusmali:* E kam lexuar.

*Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":* Ne nuk kemi qenë të thirrur.

*Z. I. Rusmali:* Nuk keni qenë të thirrur zyrtarisht?

*Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":* Zyrtarisht! Si rrallëherë, vetëm këtë dua ta shtjelloj pak. Në çdo komunikim që na bëhet për një mbledhje publike pranë Komisionerit, ose dhe pranë jush, ku ne kemi interes, ne thirremi zyrtarisht. Ju e dini shumë mirë, nga KQZ-ja. Në këtë rast nuk kemi qenë të thirrur. Unë e kam verifikuar këtë gjë, domethënë që Komisioneri po shkonte të merrte një vendim, nëpërmjet kanalit YouTube.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.04.03.2022*

**Z. I. Rusmali:** Ndoshta për shkak të faktit që Komisioneri ka menduar që juve s'keni nevojë të thirreni sepse nuk keni interes të ligjshëm?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Jo, nuk besoj se ka qenë ky fakt. Interesi i ligjshëm është i të gjitha subjekteve. Po të shihni në letërkëmbimin e pasur...Më falni të them mendimin tim!

**Z. I. Rusmali:** Dakord, por kam frikë se s'janë dakord kolegët!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":**...dhe subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë, por dhe koalicioni "Shtëpia e Lirisë" kanë sjellë nëpërmjet kryetares së Bashkisë Shkodër, kanë sjellë shkresa, për të cilën ata vetë kërkojnë ...

**Z. I. Rusmali:** Jo, këtë nuk mund ta thuash! Kryetarja e Bashkisë Shkodër i ka sjellë shkresat dhe ka insistuar, në titullin e vet, si kryetare e bashkisë, për shkak të kompetencës së vet.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Dakord! Fakti është që ky letërkëmbim që unë them dhe kërkesat për marrjen e masave të menjëhershme dhe për shkak dhe të afatit shumë të ngushtë, në të cilin gjendemi, kanë qenë shkresa zyrtare dhe janë administruar pranë Bashkisë Shkodër, dhe nga vetë Partia Socialiste dhe nga koalicioni "Shtëpia e Lirisë". Ky është interesi ynë më i madh.

**Z. I. Rusmali:** Ndoshta unë e njoh gabim Kodin, por me siguri ju mund të më korrigjoni. Subjektet elektorale kanë një të drejtë të kontestojnë caktimin e qendrave të caktuara të votimit, në mjediset private. Në qoftë se gjykojmë se ato qendra votimi,

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

në ato mjedise cenojnë neutralitetin e qendrës së votimit ndaj subjekteve elektorale, apo jo? Ne nuk jemi në këtë rast, apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Ne jemi në rast të *sui generis* dhe ju këtë gjë e dini shumë mirë!

**Z. I. Rusmali:** Po në këtë rast nuk jemi!


**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Pavarësisht pyetjes, ne jemi në një rast analog, i nderuar zoti Rusmali, për të cilin ju jeni votuar nga Parlamenti Shqiptar për të qenë anëtar i një komisioni, dhe për t'u shprehur për interesin madhor të një procesi të rregullt zgjedhor dhe...

**Z. I. Rusmali:** Nuk jemi te ky rast!

**Z. E. Çefa:** Kam një pyetje për administratën. Diku pashë që procedura është parashikuar qartësisht që në këto raste kur diskutohet për spostimin e qendrave të votimit, automatikisht në mbledhjen e KQZ-së thirren subjektet politike. Pra, në këtë rast pyetja e parë është, a jam gabim apo e kam saktë këtë? Dhe e dyta, pse nuk janë thirrur jo vetëm koalicioni, por edhe subjektet e tjera politike që garojnë në Shkodër domethënë, Partia Socialiste, Partia Demokratike? Pse nuk janë njoftuar, dhe ndoshta mos do ishte mirë që dhe ato të ishin sot për t'i marrë një opinion në seancën e themelit?

**Z. Y. Merkaç:** Për sot janë njoftuar, dhe për atë ditë janë njoftuar, por janë njoftuar me telefon. Ka qenë shumë e shkurtër koha dhe unë mund të sjell një shembull që

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.03.2022*

Partia Demokratike, e cila ishte njoftuar, ka bërë një kërkesë për shtyrjen e mbledhjes, dhe e kemi me e-mail këtë. Kjo tregon që janë njoftuar të tria partitë, janë njoftuar me telefon për shkak të kohës së shkurtër.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit "SH-L":** Nuk është e vërtetë!

**Z. E. Çefa:** Po flasim për seancën e sotme apo mbledhjen e Komisionerit?

**Z. Y. Merkaç:** Për mbledhjen, seancën e sotme janë njoftuar.

**Z. L. Braho:** Kjo është bërë seancë publike? Dhe s'ka pasur asnjë të pranishëm përveç administratës së KQZ-së.

**Z. Y. Merkaç:** S'ka pasur asnjë, por nga PD-ja kemi pasur një kërkesë për shtyrjen e seancës.

**Z. L. Braho:** Është pranuar apo s'është pranuar?

**Z. Y. Merkaç:** Nuk është pranuar se ka vazhduar seanca.

**Z. E. Çefa:** Në rregull!

**Z. Y. Merkaç:** Për çështjen e dytë do flasim më vonë?

**Z. E. Çefa:** Për çështjen e dytë, ta sqarojmë këtë pastaj mbledhemi për çështjen e dytë.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Rifillon seanca**

**Ora 11:22**

---

**Z. E. Çefa:** Atëherë, KAS-i i konsultuar në vend, vendosi:

- Moskalimin e çështjes për shqyrtim, për shkak të mungesës së legjitimitetit të ankuesit, me shumicë votash.
- Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe keni afat 5 ditë për ankimin në Kolegjin Zgjedhor.

Seanca deklarohet e mbyllur!

**Vendim nr. 9**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

